



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:072147
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05629252

A.nr.633/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçi, në konfliktin administrativ të paditësit E..K..me adresë në Rr. “T..”-P., kundër të paditurit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës –Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit A.nr.1042/22 të datës 23.01.2023 të marrë nga KPMSHCK, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datën 26.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E..K..nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi me nr. A.nr.1042/22 i datës 23.01.2023 të marrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt në kuptim të nenit 41 të LKA-së me praninë e palës paditëse dhe në mungesë të palëve të paditura të ftuar në mënyrë të rregullt, të njëjtat kanë paraqitur parashtrësë për mospjesëmarrje në seancë.

Paditësi me padinë e datës 22.03.2023, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi A.nr.1042/22 të datës 23.01.2023 i marrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të detyrohet e paditura që paditësin E..K..ta caktoj në pozitën e njëjte dhe në institucionin e njëjte: Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, në kuadër të Departamentit Ligjor dhe Traktet, në Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës –Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaroi: *“qëndroj ne tërësi pas padisë time duke shtuar edhe një element të diskriminimit të drejtpërdrejtë sipas nenit 4 të Ligjit kundër Diskriminimit kundër kandidatës e cila është caktuar ne pozitën time të cilën ekskluzivisht e kam ushtruar nga viti 2014 deri ne vitin 2022, me faktin se trajtimi i dokumentacionit i fakteve mbi përvojën e punës ku rregullorja për standardizim i jep fuqi kandidatit me përvoja me të lartë të sistemohet ne pozitën që ka ushtruar dhe ushtron momentalisht. Kriteri i njohjes së gjuhës angleze është antiligjor sepse nuk përcaktohet me ligj të veçantë, nuk ka norme juridike ligjore që i specifikon kriteret e veçanta për njohjen e gjuhës angleze në nivelin B1, C1. Baza ligjore për konsultimin e MPJ është specifike dhe për njohuri tuajën ju njoftoj se ligji mbi zyrtaret publik nrr06L/2014 i cili ka qene ne fuqi ne momentin e rregullores për organizimin e brendshëm Neni 4 specifikon ne veçanti “Nëpunësit profesional ne shërbimin diplomatik dhe ne shërbimin korrektues ne Kosove janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi me ligj të veçantë për këto kategori duhet të jete ne pajtim me parimet e ligjit për zyrtar publik dhe a ligj specifik mund të rregulloj ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës, kushtet e veçanta sipas nenit 4.2.4 sipas ligjit mbi zyrtaret publik si rregullim specifik apo i veçantë parashihet transferimi dhe sistematizimi i nëpunësve, një veprim që nuk është bere dhe nuk është ne fuqi, sepse tash janë ne fuqi dispozitat e ish Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe jo pas fuzionimit të këtyre dy ministrive. Tek çështja e caktimit të kandidatës ne pozitën time është bere diskriminim i drejtpërdrejtë me faktin se nuk është respektuar barazia e palëve gjate procesit të caktimit të zyrtarit ne këtë pozite. Kandidatja ne fjale është transferuar ne pozitën e zyrtares së lartë nga pozita shefe e njësisë për të drejtat e njeriut ne komunën e Podujevës pozite kjo e ushtruar nga ajo për mbi dhjetë vite, kurse ne cilësinë e udhëheqjes për çështje ligjore është caktuar ne vitin 2020. Kohëzgjatja e punës time ne cilësinë e udhëheqësit të divizionit dhe përvoja mbi 30 vjeçare jep baze ligjore që kjo gjykatë racionalisht të vlerësoj çështjen dhe të vendos që unë të kthehem ne pozitën time të mëparshme kurse për demin moral që është shkaktuar nga klani i brendshëm jo kompetent i MPJD kërkoj kompensim ne dem 20 mijë euro. Kjo cilësohet si diskriminim i drejtpërdrejt”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“I propozoj gjykatës që gjate shqyrtimit të padisë time të fokusohet ne dispozitat ligjore që kanë qene ne fuqi gjate periudhës së hartimit të rregullores për organizimin e brendshëm të MPJD ne veçanti Ligjit për zyrtar publik neni 4 i vitit 2019, rregullores nr. 26/2020, ekskluzivisht nenit 19 ku gjate procesit të klasifikimit të punës për kritere ndaj zyrtareve publik është dashur të ndodhin ndryshime ne legjislacionin specifik për caktimin e kriterëve të veçanta. Andaj, kërkoj që padia ime ne plotni të aprovohet nga kjo gjykatë duke me kthyer ne pozitën time të mëparshme si dhe duke aprovuar kompensimin e demit moral ne shumën e lartcekur”.*

E paditura e parë Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me përgjigjjen në padi të datës 08.06.2023 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se vendimi i atakuar me kërkesëpadi është nxjerrë konform dispozitave ligjore të nenit 54 par.1 dhe 2 të Ligjit për Zyrtarët Publik, sepse është plotësuar kriteri i transferimit në kategori të njejtë si dhe kriteri i plotësimit të kushteve dhe kualifikimit për pozitën përkatëse, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike. I propozon gjykatës që të refuzohet kërkesëpadija e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi Këshillit numër A.nr.1042/22 i datës 23.01.2023, si i bazuar në ligj.

E paditura e dytë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në përgjigjen në padi të datës 04.07.2023, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke pohuar se paditësi i kishte plotësuar kualifikimet e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, mirëpo nuk i ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhës angleze, kështu që mbi këtë bazë Komisioni kishte bërë propozimin të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesi të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzon padinë si të pabazuar dhe lë në fuqi vendimin e kontestuar të Këshillit.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Vendimi me nr. A.nr.1042/2022 i dt.23.01.2023, ankesa e dt.23.11.2022, vendimi nr.146/2022 i dt.10.11.2022, vendimi i dt.05.10.2022, vendimi me nr.139/22 i dt.15.09.2022, ankesa e dt.07.10.2022, aktemërimi i dt.10.03.2014, raporti i veçantë i punës i dt.31.10.2022, vërtetimi i marrëdhënies së punës i dt.10.06.2015, letër emërimi i dt.27.07.2004, letër rekomandimi i dt.12.09.2005, email i dt.19.09.2022, mendimet për kandidatet në pozitën në fjalë, certifikata e dt.13.06.2000 dhe dokumente të tjera përcjellëse duke i përfshirë edhe certifikatat, urgjenca e dt.27.10.2022, përgjigja në njoftim e dt.18.03.2022, certifikata e gjuhës angleze pa date të lëshimit, vërtetimet lidhur me përvojën e punës të paditësit si dhe formularët e vlerësimit të rezultateve në punë, certifikata e arritjeve personale të personit A.. P..si dhe CV personale, aktemerimet dhe vendimet për A.. P.. si dhe formular të vlerësimeve në punë, konkursi për lëvizje brenda kategorisë i dt.26.05.2021, vendimi i dt.28.12.2022, përgjigja shtese në ankese e dt.27.01.2023, aktemërimi i A.. P..i dt.13.06.2022, vendimi për transferim i dt.10.05.2022, diplomat dhe certifikatat universitare, deklarata e të paditurës së pare e dt.18.04.2024, certifikata nga KETNET dhe komunikimi elektronik të dt.26.01.2022, vërtetimin e dt.08.04.2024, certifikatën e dt. 05.05.2023 dhe raportin e mjekut të dt.13.12.2023.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij dhe gjeti se padia është e pabazuar.

Gjykata konstatoi se procedura administrative e zhvilluar tek organi i paditur është zhvilluar në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata poashtu gjeti se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe me të drejtë janë trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit.

Gjykata konstatoi se vendimi i të paditurës nuk është në kundërshtim me nenin 47 të LPPA-së, për faktin që vendimi përmban pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin si dhe këshillën juridike.

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 47, paragrafin të LPPA-së në të cilin përcaktohet: *“Neni 47-Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar*

1. Akti administrativ i shkruar përmban:

1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;

1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.

1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrative apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

Gjykata poashtu konstatoi se vendimi i të paditurës nuk është në kundërshtim as me nenin 48 të LPPA-së, për faktin që nga vlerësimi dhe analizimi i pjesës arsyetuese, gjykata erdhi në përfundim se në pjesën arsyetuese janë dhënë sqarime të detajuara edhe të dispozitave ligjore mbi të cilat është marrë vendimin i kundërshtuar me padi. Në lidhje me këtë gjykata ju referua nenit 48 të LPPA-së ku përcaktohet si në vijim: “Neni 48- Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsytet pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërrthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Gjykata gjeti se i padituri i dytë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me rastin e marrjes së vendimit të goditur me padi, me të drejtë kishte konstatuar se paditësi i kishte plotësuar kualifikimet e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, mirëpo nuk i ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhës angleze, kështu që mbi këtë bazë Komisioni kishte bërë propozimin te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesi të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se natyra e një pozite të tillë në shërbimin civil, kishte implikuar nevojën për kualifikim të posaçëm të njohjes së gjuhës angleze, gjë të cilën nuk e kishte përmbushur në atë kohë paditësi, ashtu që si rezultat i kësaj, i padituri i parë, me të drejtë kishte transferuar paditësin në një pozicion tjetër të shërbimit civil i cili i ishte përshtatur kualifikimeve të përgjithshme dhe të veçanta të paditësit si dhe përvojën e tij të punës.

Gjykata refuzoi pretendimet e paditësit rreth caktimit të një personi të tretë në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për faktin që në këtë konflikt administrativ gjykata kishte tagër

dhe autorizime specifike që të vlerësonin vetëm pretendimet e paditësit për paligjshmërinë eventuale të akteve administrative që i referohen në mënyrë specifike vetëm paditësit.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësja. Mbi këto arsye thënie të paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.633/23, datë 26.04.2024

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçi

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.